



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republicof Kosovo
Komuna e Prishtinës
Opština Priština -Municipality of Prishtina



EKSTRAKT I PROCESVERBALIT

të mbledhjes së pestë të Kuvendit, mbajtur më 14.06.2021, e cila filloj në orën 10:00.

Në mbledhje morën pjesë: Agim Kuleta, kryesues i Kuvendit, këshilltarët e Kuvendit: Vala Peshku, shefe e GP-së (PSD), Drilon Pireva (PSD), Genc Sherifi (PSD), Mimoza Sylejmani (PSD), Qëndrim Sahiti (PSD), Nol Nushi (PSD), Leonora Shabani - Bajraktari, shefe e GP-së (LVV), Vjosa Hamiti - Krasniqi (LVV), Arbër Vokrri (LVV), Besnik Mujeci (LVV), Egzon Azemi (LVV), Naim Hoxha (LVV), Nazlie Bala (LVV), Halim Halimi, shef i GP-së (LDK), Mustafë Krasniqi (LDK), Sami Salihu (LDK), Milazim Vitija (LDK), Shefqet Osmani (LDK), Agim Gashi (LDK), Shefki Gashi (LDK), Hafiz Krasniqi (LDK), Haki Dragusha (LDK), Naime Osmani (LDK), Vjollca Rizanin (LDK), Jeta Rafuna - Hasani (LDK), Elmire Nikçi - Rexha (LDK), Kushtrim Sopa (LDK), Blerand Stavileci, shef i GP-së (PDK), Kumrije Shabani - Ramadani (PDK), Leutrim Retkoceri (PDK), Muhamet Selmani (PDK), Suzan Kika, (PDK), Florida Canolli (PDK), Fadil Gashi, shef i GP-së (AAK), Valbona Ajeti (AAK), Bukurie Canolli (AAK), Fiknete Bejta (Grupi i pavarur), Vesel Makolli, shef i GP-së (AKR), Arbenita Murseli (AKR), Sami Boroci (AKR), Granit Shala (Nisma), Rifat Deri (i pavarur), Sokol Berisha (Grupi i pavarur) dhe Kreshnik Smajlaj (Grupi i pavarur).

Munguan: Migjen Shala (PDK), Visare Gashi (PSD), Bashkim Beha (PSD), Mirsad Vitia (LVV), Adelina Fazliji (AKR) dhe Valbona Petrovci (e pavarur).

Të pranishëm ishin edhe: Shpend Ahmeti, kryetar i Komunës, Valbona Makolli, drejtoreshë e Drejtorisë së Financave, Gëzim Mehmeti, drejtor i Drejtorisë së Investimeve Kapitale dhe Menaxhimit të Kontratave, Ardian Olluri, drejtor i Drejtorisë së Urbanizmit, Valbona Ajeti, drejtoreshë e Drejtorisë së Kadastrit, Adrian Berisha, drejtor i Drejtorisë së Kulturës, Fitim Rexha, drejtor i Drejtorisë së Sportit, Dren Kukaj, drejtor i Drejtorisë së Mirëqenies Sociale, Genc Bashota, drejtor i Drejtorisë së Planifikimit Strategjik dhe Zhivillimit të Qëndrueshëm, Vasilika Zotaj, drejtoreshë e Drejtorisë së Administratës, Shpresa Shala, drejtoreshë e Drejtorisë së Arsimit, Osman Bllaca, përfaqësues i ekzekutivit, përfaqësues të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, përfaqësues të OJQ-ve dhe përfaqësues të medieve.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi **Agim Kuleta**, kryesues i Kuvendit.

Para se të fillonin me diskutimin për rendin e ditës, kryesuesi e ftoi anëtarin e ri të Kuvendit, z. Berat Lahu, që të jepë betimin para Kuvendit.

Kryesuesi hapi diskutimin për rendin e ditës.

Faqe 1 nga 15

Shpend Ahmeti, kryetar, i njoftoi të pranishmit duke cekur se në Ligjin për vetëqeverisje lokale është një nen, i cili thotë se pas shpalljes së zgjedhjeve nga ana e presidentes, atëherë as Kuvendi komunal e as ekzekutivi, nuk mund të marrë vendime për prona, dhe ne kemi vendosur që ta mbajmë mbledhjen sot, në mënyrë që t'i kryejmë këto vendime që kanë të bëjnë me këmbimin e pronave.

Ai kërkoi që të shtohet pika e rendit të ditës: "Propozimvendimi për ndihmë Komunës së Preshevës, në shumën prej 50.000 euro, për rastin e fatkeqësive natyrore.

Po ashtu, propozoi që nga rendi i ditës të hiqet pika e trembëdhjetë: "Propozimvendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës me pronën e paluajtshme në pronësi të Bedri Humollit dhe "Agro Trade", për shkak se nuk është materiali i kompletuar.

Njëherësh propozoi që pika e katërt: "Propozimvendimi për dhënie në shfrytëzim të pronës së paluajtshme komunale NPL "Sport Marketing", SHA, Prishtinë, të bëhet bashkë me pikën e shtatëmbëdhjetë: "Propozimvendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës me pronën e paluajtshme në pronësi të Sutki Humollit dhe Betim Humollit, sepse është diskutimi i njëjtë.

Gjithashtu, është edhe një kërkesë e festivalit "Suny Hill", për gjetjen e një hapësire të përherershme për organizimin e festivalit "Suny Hill" dhe aktivitetet rreth festivalit që mos të mbahet në Gërmë.

Sami Boroci propozoi që në rend të ditës të futen këto pika: "Propozimvendimi për ndryshimin e Vendimit për përcaktimin e kompensimit të aksionarëve të ndërmarrjeve publike lokale"; "Propozimvendimi për këmbimin e pronës komunale me pronën e paluajtshme në pronësi të Bajrush Plakajt dhe Propozimvendimi për këmbimin e pronës komunale me pronën e paluajtshme në pronësi të Bedri Sadikut, Naser Havollit dhe Naser Lalës.

Egzon Azemi propozoi që në rend të ditës të futet pika: "Kthimi i laurës së Gërmisë në menaxhimin e Hortikulturës".

Fiknete Bejta propozoi që në rend të ditës të futet pika: "Propozimvendimi për ndryshimin e Vendimit për përcaktimin e kompensimit të aksionarëve të ndërmarrjeve publike lokale".

Leutrim Retkoceri propozoi që në rend të ditës të futen pikat: "Propozimvendimi për formimin e një komisioni me një afat ligor, i cili bën emërtimin dhe riemërtimin e rrugëve" dhe "Propozimvendimi për subvencionimin e Shoqatës së Invalidëve të UÇK-së, Dega në Prishtinë.

Agim Gashi shprehu mendimin se NPL "Hortikultura" nuk është e thirrur me menaxhuan parkingje e laura, por është e thirrur që të trajtojë, t'i kultivojë hapësirat gjelbëruese, të kultivojë, të përgatit kapacitete punuese brenda ndërmarrjes, njerëz që dinë të mbjellin, të krasisin, të kositin, të kultivojnë lule, fidanë për nevoja të Hortikulturës, e jo të merren me menaxhimin e parkingjeve.

Lidhur me çështjet e ngritura të laurës në hyrje të parkut "Gërmia", sqarime të nevojshme dha Shpend Ahmeti, krytar.

Hafiz Krasniqi u shpreh se është Komiteti për Politikë dhe Financa i cili duhet bërë kristalizimin gjithmonë të pikave të rendit të ditës. Disa pika mund të hyjnë në rend të ditës, nëse vërtetë janë shumë emergjente, por në këtë rast nuk po shoh pika emergjente që duhet me e bërë gjithë këtë bisedë, kështu që Hortikultura nuk e ka absolut në aktin e themelimit menaxhimin e laurave.

Leutrim Retkoceri tha se duke pasur parasysh gjendjen e krijuar në disa ndërmarrje publike lokale, e në veçanti në ndërmarrjen publike lokale "Hortikultura", propozoi që të futet si pikë e rendit të ditës shkarkimi i aksionarëve të kësaj ndërmarrje dhe të zëvendësohen me aksionarë të rinj.

Lidhur me kërkesë e festivalit "Suny Hill" për gjetjen e një hapësire të përhershme për organizimin e festivalit "Suny Hill" dhe aktivitetet rrreth festivalit, të pranishmit në pika të shkurtra i informoi Dukagjin Lipa, përfaqësues i "Suni Hill"-it.

Osman Bllaca, përfaqësues i ekzekutivit, propozoi që në rend të ditës të futen edhe këto pika:

- Propozimvendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës me pronën e paluajtshme në pronësi të Hamëz Ismail Lladrovci;
- Propozimvendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës me pronën e paluajtshme në pronësi të Granit Hakif Berishës;
- Propozimvendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës me pronën e paluajtshme në pronësi të "Bau Holding", Bajram Gashanit, Mexhid Dobre, Isa Gacaferit, Valdrin Bekës, Vjollca Limanit, Kushtrim Maliqit, Shkurte Rizanit, Mentor Zeqirit, Mensur Zeqirit dhe Melihate Zeqirit;
- Propozimvendimi për një nismë për bashkëpunim ndërkomunal, ka të bëjë me Komunën e Prishtinës dhe Komunën e Lipjanit për një rrugë, e cila do të shtrohet në mes të dy fshatrave, Slivovë dhe Peshter dhe
- Propozimvendimi për fillimin e Planit rregullues të hollësishëm për zonën "Mati1", vazhdimi i rrugës "B", rruga Xheladin Hana, pjesa verilindore.

Kryesuesi i hodhi në votim pikat e propozuara:

- **Kryesuesi** konstatoi se më 31 vota për, u miratua propozimi që Propozimvendimi për ndihmë Komunës së Preshevës, në shumën prej 50.000 euro, me rastin e fatkeqësive natyrore, hynë në rend të ditës për diskutim;
- **Kryesuesi** konstatoi se më 37 vota për, u miratua propozimi që Propozimvendimi për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme komunale festivalit "Suni Hill" hyn në rend të ditës për diskutim;
- **Kryesuesi** konstatoi se më 26 vota për, 3 kundër dhe 2 abstenime, u miratua propozimi që Propozimvendimi për ndryshimin e vendimit për përcaktimin e kompensimit të aksionarëve të ndërmarrjeve publike lokale dhe KRM "Pastrimi", hyn në rend të ditës për diskutim;

- Kryesuesi konstatoi se më 23 vota për, u miratua propozimi që Propozimvendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës me pronën e paluajtshme në pronësi të Bajrush Ramiz Plakajt, hyn në rend të ditës për diskutim;
- Kryesuesi konstatoi se më 21 vota për dhe 5 abstenime, u miratua Propozimvendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës me pronën e paluajtshme në pronësi të Bedri Sadikut, Naser Havollit dhe Naser Lalës;
- Kryesuesi konstatoi se më 9 vota për, 14 kundër dhe 9 abstenime nuk u miratua Propozimi për kthimin e laurës së Gërmisë në menaxhimin e Hortikulturës;
- Kryesuesi konstatoi se më 31 vota për dhe 2 abstenime, u miratua propozimi i Kryetarit, që pika e katërt e rendit të ditës kalon në pikën e gjashtëmbëdhjetë, kështu që pika e gjashtëmbëdhjetë dhe e shtatëmbëdhjetë të janë afër njëra-tjetrës për shkak të ngashmërisë së tyre;
- Kryesuesi konstatoi se të pranishëm në sallë janë 38 anëtarë të Kuvendit dhe më 19 vota për dhe 6 abstenime, u miratua propozimi që Propozimvendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës me pronën e paluajtshme në pronësi të Hamz Ismail Lladrovcit, hyn në rend të ditës për diskutim;
- Kryesuesi konstatoi se më 19 vota për dhe 8 abstenime, u miratua propozimi që Propozimvendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës me pronën e paluajtshme në pronësi të Granit Hakif Berishës, hyn në rend të ditës për diskutim;
- Kryesuesi konstatoi se më 23 vota për, 1 kundër dhe 5 abstenime, u miratua propozimi që Propozimvendimi për këmbimin e pronës së Komunës me pronën e paluajtshme në pronësi të "Bau Hollding", Bajram Gashanit, Mexhid Dobrës, Isa Gacaferit, Valdrin Bekës, Vjollca Limanit, Kushtrim Maliqit, Shkurte Rizanit, Mentor Zeqirit, Mensur Zeqirit dhe Melihate Zeqirit, hyn në rend të ditës për diskutim;
- Kryesuesi konstatoi se më 33 vota për u miratua propozimi që Propozimvendimi për nismën e bashkëpunimit ndërkomunal, hyn në rend të ditës për diskutim;
- Kryesuesi konstatoi se më 31 vota për, 1 kundër dhe 2 abstenime, u miratua propozimi që Propozimvendimi për fillimin e Planit rregullues të hollësishëm për zonën "Mati 1", vazhdimi i rrugës "B", rruga "Xheladin Hana", pjesa verilindore, hyn në rend të ditës për diskutim;
- Kryesuesi konstatoi se më 26 vota për, 11 kundër dhe 2 abstenime, u miratua propozimi që Propozimvendimi për shkarkimin e aksionarëve të NPL "Hortikultura", hyn në rend të ditës për diskutim.

Me ndryshime dhe propozimet e dhëna, kryesuesi konstatoi se më 28 vota për, u miratua ky

Rend i ditës:

1. Miratimi i ekstraktit të procesverbalit të mbledhjes së katërt të Kuvendit të Komunës së Prishtinës;
2. Propozimvendimi për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme komunale, "Suny Hill Festival";
3. Propozimvendimi për plotësim-ndryshimin e Vendimit, 01.463/01-27259/21, të dt. 11.02.2021 për këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës me pronë private;

4. Propozimvendimi për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme komunale, NPL "Sport Marketing", SHA, Prishtinë;
5. Propozimvendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës së Prishtinës, pasuri shoqërore, "Ujërat", Prishtinë, me pronën e paluajtshme në pronësi, pronë shoqërore, BVI për Banim;
6. Propozimvendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës me pronën e paluajtshme në pronësi të Tahir (Liman) Sylejmanit dhe Jahir (Liman) Sylejmanit;
7. Propozimvendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës me pronën e paluajtshme në pronësi të Nexhmije (Murat) Rexhepit dhe Sami (Xhemajl) Qyqallës;
8. Propozimvendimi për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme komunale Kompanisë Kosovare për Distribuim dhe Furnizim me Energji Elektrike (KEDS);
9. Propozimvendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës me pronën e paluajtshme në pronësi të Tahir Sylejmanit dhe "Agullimi-A", SHPK;
10. Propozimvendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës me pronën e paluajtshme në pronësi të "Tregtia", SHPK, dhe Bedri Prishtinës;
11. Propozimvendimi për plotësim-ndryshimin e Vendimit, nr. 01.046-157056, të dt. 27.08.2013, për këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës, me pronën e paluajtshme në pronësi private të New company "Kosovashped", Pjetër Palushi dhe Shkelzen Noka;
12. Propozimvendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës me pronën e paluajtshme në pronësi të "Real Estate Kosova", SHPK;
13. Propozimvendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës me pronën e paluajtshme në pronësi të Liman Jasharit;
14. Propozimvendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës me pronën e paluajtshme në pronësi të Rexhep Shoshit;
15. Propozimvendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës me pronën e paluajtshme në pronësi të Sutki Humollit dhe Betim Humollit;
16. Propozimvendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës me pronën e paluajtshme në pronësi të Rrahman Haradinit dhe Shaban Konxhelit;
17. Propozimvendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës me pronën e paluajtshme në pronësi të Fatmir Gashit dhe Fitim Gashit;
18. Propozimvendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës me pronën e paluajtshme në pronësi të Hamzë (Ismajl) LLadrovcit;
19. Propozimvendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës me pronën e paluajtshme në pronësi të Granit (Hakif) Berishës;
20. Propozimvendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës me pronën e paluajtshme në pronësi të "Bau Holding", Bajram Gashanit, Mexhid Dibrës, Isa Gacaferit, Valdrin Bekës, Vjollca Limanit, Kushtrim Maliqit, Shkurte Rizanit, Mentor Zeqirit, Mensur Zeqirit, dhe Melihate Zeqirit;
21. Propozimvendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës me pronën e paluajtshme në pronësi të Bajrush (Ramiz) Plakajt;
22. Propozimvendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës me pronën

- e paluajtshme në pronësi të Bedri Sadikut, Naser Havollit dhe Naser Lalës;
- 23. Propozimvendimi për nismën e bashkëpunimit ndërkomunal;
 - 24. Propozimvendimi për ndryshimin e Vendimit për përcaktimin e kompensimit të aksionarëve të ndërmarrjeve publike lokale;
 - 25. Propozimvendimi për fillimin e Planit rregullues të hollësishëm për zonën "Mati 1", vazhdimi i rrugës "B" ("Xheladin Hana") - pjesa verilindore;
 - 26. Propozimvendimi për ndryshimin e Vendimit, 01.nr. 110-21449, të dt.28.02.2013;
 - 27. Propozimvendimi për krijimin e komisionit për caktimin e kritereve për ndarjen e subvencioneve të kompanive private që operojnë me autobusë në linjat e transportit publik urban;
 - 28. Propozimvendimi për shkarkimin e aksionarëve të NPL "Hortikultura";
 - 29. Propozimvendimi për ndihmë Komunës së Preshevës, në shumë prej 50.000 euro, për rastin e fatkeqësive natyrore;
 - 30. Pyetje dhe përgjigje;
 - 31. Të ndryshme.

Pika e parë

Miratimi i ekstraktit të procesverbalit të mbledhjes së katërt të Kuvendit të Komunës së Prishtinës.

Kryesuesi konstatoi se më 39 vota për, 1 kundër dhe 2 abstenime, u miratua ekstrakti i procesverbalit të mbledhjes së katërt të Kuvendit të Komunës së Prishtinës.

Pika e dytë

Propozimvendimi për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme komunale "Suni Hill Festival".

Agim Gashi tha se ne si grup parlamentar e përkrahim këtë propozimvendim, por do të ishte mirë që në marrëveshtjen e bashkëpunimit apo kontratën që do ta nënshkruajnë më vonë të jetë një dakordim mes palëve kontraktuese, që mundësish kjo hapësirë të jetë e lirë edhe për aktivitete të tjera.

Suzan Kika tha se edhe ne si Grup parlamentar e përkrahim këtë propozimvendim, por gjithashtu me shpresën dhe dëshirën që të organizohen sa më shumë evenete të këtij lloji në qytetin tonë.

Vala Peshku tha se kjo është një prej gjërave më të bukura që i ndodhin kësaj Prishtine, kështu që besoj se ndoshta është paksa privilegji i këtij Kuvendi komunal me votuar një gjë të tillë për "Suni Hill Festival".

Sami Boroci tha se edhe ne si grup parlamentar e përkrahim këtë propozimvendim, pra ndoshta e kemi privilegjin edhe ne me e votuar një vendim të tillë, me dhënë një hapësirë e që mendoj se do të shndërrohet në një hapësirë, e cila ka me u shfrytëzuar shumë mirë edhe për evenete të tjera.

Fiknete Bejta tha se ne si asamblistë duhet me u ndier krenar që kemi mundësi të marrim vendime të tilla për të miratuar dhënien e pronës së Komunës për qëllime dhe evenete të tilla.

Kisha sugjeruar që marrëveshja me fondacionin "Suni Hill" të jetë e qartë dhe precise që pastaj mos të kemi telashe.

Drilon Pireva tha se ky është një projekt shumë i qëlluar, mirëpo ishte dashur dikush nga Drejtoria e Pronës me na treguar për parcelën, madhësinë e sajë, pra që ne ta kemi sa më të qartë se për cilën tokë bëhet fjalë.

Adrian Berisha, drejtor, tha se në "Suni Hill" kam pasur kënaqësi me punuar dhe e di saktësish ndikimin që një festival, si "Suni Hill" e ka për ekonominë e qytetit tonë, por jo vetëm për ekonominë, por "Suni Hill" ndikon edhe në imazhin e qytetit tonë të dashur të Prishtinës.

Kryesuesi konstatoi se njëzëri, më 30 vota për, u miratua Vendimi për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme komunale "Suni Hill Festival".

Pika e tretë

Propozimvendimi për plotësim-ndryshimin e Vendimit, 01.463/01-27259/21, të dt. 11.02.2021, për këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës me pronë private.

Kryesuesi konstatoi se më 21 vota për dhe 2 abstenime, u miratua Vendimi për plotësim-ndryshimin e Vendimit, 01.463/01-27259/21, të dt.11.02.2021, për këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës me pronë private.

Pika e katërt

Propozimvendimi për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme komunale, NPL "Sport Marketing", SHA, Prishtinë.

Kryesuesi konstatoi se njëzëri, më 28 vota për, u miratua Vendimi për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme komunale, NPL "Sport Marketing", SHA, Prishtinë.

Pika e pestë

Propozimvendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës së Prishtinës, pasuri shoqërore "Ujërat", Prishtinë, me pronën e paluajtshme në pronësi, pronë shoqërore, BVI për Banim.

Kryesuesi konstatoi se më 26 vota për dhe 2 abstenime, u miratua Vendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës së Prishtinës, pasuri shoqërore, ujërat, Prishtinë, me pronën e paluajtshme në pronësi, pronë shoqërore, BVI për banim.

Pika e gjashtë

Propozimvendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës me pronën e paluajtshme në pronësi të Tahir (Liman) Sylejmanit dhe Jahir (Liman) Sylejmanit.

Kryesuesi konstatoi se më 25 vota për dhe 5 abstenime, u miratua Vendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës me pronën e paluajtshme në pronësi të Tahir (Liman) Sylejmanit dhe Jahir (Liman) Sylejmanit.

Pika e shtatë

Propozimvendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës me pronën e paluajtshme në pronësi të Nexhmije (Murat) Rexhepit dhe Sami (Xhemajl) Qyqallës.

Kryesuesi konstatoi se më 22 vota për dhe 6 abstenime, u miratua Vendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës me pronën e paluajtshme në pronësi të Nexhmije (Murat) Rexhepit dhe Sami (Xhemajl) Qyqallës.

Pika e tetë

Propozimvendimi për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme komunale Kompanisë Kosovare për Distribuim dhe Furnizim me Energji Elektrike (KEDS).

Kryesuesi konstatoi se njëzëri, më 30 vota për, u miratua Vendimi për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme komunale Kompanisë Kosovare për Distribuim dhe Furnizim me Energji Elektrike (KEDS).

Pika e nëntë

Propozimvendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës me pronën e paluajtshme në pronësi të Tahir Sylejmanit dhe "Agullimi - A", SHPK.

Kryesuesi konstatoi se më 26 vota për dhe 3 abstenime, u miratua Vendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës me pronën e paluajtshme në pronësi të Tahir Sylejmanit dhe "Agullimi - A", SHPK.

Pika e dhjetë

Propozimvendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës me pronën e paluajtshme në pronësi të "Tregtia", SHPK dhe Bedri Prishtina.

Kryesuesi konstatoi se më 18 vota për, 1 kundër dhe 6 abstenime, u miratua Vendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës me pronën e paluajtshme në pronësi të "Tregtia" SHPK dhe Bedri Prishtina.

Pika e njëmbëdhjetë

Propozimvendimi për plotësim- ndryshimin e Vendimit nr. 01.046-157056, të dt. 27.08.2013, për këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës me pronën e paluajtshme në pronësi private të New Company "Kosovashped", Pjetër Palushi dhe Shkëlzen Noka.

Muhamed Selmani ngriti shqetsim rreth këtij këmbimi, i ci tha se këmbimi i kësaj parcele, me sipërfaqe prej 88 arë, ka një vlerë shumë të madhe, sepse është një zonë ku është zona me ndërtimin më të lartë në qytetin e Prishtinës.

Lidhur me shqetsimin e ngritur nga z. Muhamed Selmani, sqarime shtesë dha Shpend Ahmeti, kryetar.

Kryesuesi konstatoi se më 23 vota për dhe 5 abstenime, u miratua Vendimi për plotësim-ndryshimin e Vendimit, nr. 01.046-157056, të dt. 27.08.2013, për këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës me pronën e paluajtshme në pronësi private të New Company "Kosovashped", Pjetër Palushi dhe Shkëlzen Noka.

Pika e dymbëdhjetë

Propozimvendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës me pronën e paluajtshme në pronësi të "Real Estate Kosova", SHPK.

Lidhur me këtë pikë diskutuan Shpend Ahmeti dhe Muhamed Selmani.

Kryesuesi konstatoi se më 23 vota për, 1 kundër dhe 2 abstenime, u mirtua Vendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës me pronën e paluajtshme në pronësi të Real Estate Kosova, SHPK.

Pika e trembëdhjetë

Propozimvendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës me pronën e paluajtshme në pronësi të Liman Jasharit.

Lidhur me këtë pikë diskutuan Shpend Ahmeti, kryetar, Kushtrim Sopa dhe Muhamed Selmani.

Kryesuesi konstatoi se më 24 vota për dhe 5 abstenime, u miratua Vendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës me pronën e paluajtshme në pronësi të Liman Jasharit.

Pika e katërmëdhjetë

Propozimvendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës me pronën e paluajtshme në pronësi të Rexhep Shoshit.

Kryesuesi konstatoi se më 28 vota për, 1 kundër dhe 2 abstenime, u miratua Vendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës me pronën e paluajtshme në pronësi të Rexhep Shoshit.

Pika e pesëmbëdhjetë

Propozimvendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës me pronën e paluajtshme në pronësi të Sutki Humollit dhe Betim Homullit.

Kryesuesi konstatoi se më 19 vota për, 1 kundër dhe 7 abstenime, u miratua Vendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës me pronën e paluajtshme në pronësi të Sutki Humollit dhe Betim Homullit.

Pika e gjashtëmbëdhjetë dhe

Pika e shtatëmbëdhjetë

Propozimvendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës me pronën e paluajtshme ne pronësi të Rrahman Haradinit dhe Shaban Konxhelit dhe Propozimvendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës me pronën e paluajtshme në pronësi të Fatmir Gashit dhe Fitim Gashit.

Lidhur me këto dy pika të rendit të ditës, të pranishmit në pika të shkurtra i njoftoi Shpend Ahmeti, kryetar.

Lidhur me këto pika diskutuan edhe Muhamet Selmani, Egzon Azemi dhe Leutrim Retkoceri.

Kryesuesi konstatoi se më 20 vota për, 1 kundër dhe 5 abstenime, u miratua Vendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës me pronën e paluajtshme në pronësi të Rrahman Haradinit dhe Shaban Konxhelit.

Kryesuesi konstatoi se më 21 vota për dhe 7 abstenime, u miratua Vendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës me pronën e paluajtshme në pronësi të Fatmir Gashit dhe Fitim Gashit.

Pika e tetëmbëdhjetë

Propozimvendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës me pronën e paluajtshme në pronësi të Hamz (Ismajl) Lladrovcit.

Kryesuesi konstatoi se më 18 vota për dhe 11 abstenime, u miratua Vendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës me pronën e paluajtshme në pronësi të Hamz (Ismajl) Lladrovcit.

Pika e nëntëmbëdhjetë

Propozimvendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës me pronën e paluajtshme në pronësi të Granit (Hakif) Berishës.

Kryesuesi konstatoi se më 17 vota për, 1 kundër dhe 10 abstenime, u miratua Vendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës me pronën e paluajtshme në pronësi të Granit (Hakif) Berishës.

Pika e njëzet

Propozimvendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës me pronën e paluajtshme në pronësi të "Bau Holding", Bajram Gashanit, Mexhid Dobrës, Isa Gacaferit, Valdrin Bekës, Vjollca Limanit, Kushtrim Maliqit, Shkurte Rizanit, Mentor Zeqirit, Mensur Zeqirit dhe Melihate Zeqirit.

Kryesuesi konstatoi se më 17 vota për dhe 10 abstenime, u miratua Vendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës me pronën e paluajtshme në pronësi të "Bau Holding", Bajram Gashanit, Mexhid Dobrës, Isa Gacaferit, Valdrin Bekës, Vjollca Limanit, Kushtrim Maliqit, Shkurte Rizanit, Mentor Zeqirit, Mensur Zeqirit dhe Melihate Zeqirit.

Pika e njëzet e njëtë

Propozimvendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës me pronën e paluajtshme në pronësi të Bajrush (Ramiz) Plakajt.

Kryesuesi konstatoi se më 18 vota për dhe 10 abstenime, u miratua Vendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës me pronën e paluajtshme në pronësi të Bajrush (Ramiz) Plakajt.

Pika e njëzet e dytë

Propozimvendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës me pronën e paluajtshme në pronësi të Bedri Sadikut, Naser Havollit dhe Naser Lalës.

Kryesuesi konstatoi se më 3 vota për, 8 kundër dhe 13 abstenime, nuk u miratua Propozimvendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës me pronën e paluajtshme në pronësi të Bedri Sadikut, Naser Havollit dhe Naser Lalës.

Pika e njëzet e tretë

Propozimvendimi për nismën e bashkëpunimit ndërkomunal.

Kryesuesi konstatoi se më 30 vota për dhe 1 abstenim, u miratua Vendimi për nismën e bashkëpunimit ndërkomunal.

Pika e njëzet e katërt

Propozimvendimi për ndryshimin e Vendimit për përcaktimin e kompensimit të aksionarëve të ndërmarrjeve publike lokale.

Lidhur me këtë pikëtë rendit të ditës diskutuan Fikneta Bejta, Vala Peshku, Berat Lahu, Egzon Azem dhe Muhamet Selmani.

Kryesuesi konstatoi se më 23 vota për dhe 4 abstenime, u miratua Vendimi për ndryshimin e vendimit për përcaktimin e kompensimit të aksionarëve të ndërmarrjeve publike lokale.

Pika e njëzet e pestë

Propozimvendimi për fillimin e Planit rregullues të hollësishëm për zonën "Mati 1", vazhdimi i rrugës "B" (Xheladina Hana) - pjesa verilindore.

Lidhur me Propozimvendimin për fillimin e planit rregullues të hollësishëm për zonën "Mati 1" vazhdimi i rrugës "B" (Xheladina Hana) - pjesa verilindore, të pranishmit në pika të shkurtra i informoi Genc Bashota, drejtor.

Kryesuesi konstatoi se më 27 vota për dhe 2 abstenime, u miratua Vendimi për fillimin e Planit rregullues të hollësishëm për zonën "Mati 1", vazhdimi i rrugës "B" (Xheladina Hana) - pjesa verilindore.

Pika e njëzet e gjashtë

Propozimvendimi për ndryshimin e Vendimit, 01. nr. 110-21449, të dt. 28.02.2013.

Lidhur me Propozimvendimin për ndryshimin e Vendimit, 01. nr. 110-21449, të dt. 28.02.2013, të pranishmit në pika të shkurtra i njoftoi Genc Bashota, drejtor.

Kryesuesi konstatoi se më 25 vota për dhe 2 abstenime, u miratua Vendimi për ndryshimin e Vendimit, 01. nr. 110-21449, të dt. 28.02.2013.

Pika e njëzet e shtatë

Propozimvendimi për krijimin e Komisionit për caktimin e kritereve për ndarjen e subvencioneve të kompanive private që operojnë me autobusë në linjat e transportit publik urban.

Për anëtarë të Komisionit për caktimin e kritereve për ndarjen e subvencioneve të kompanive private që operojnë me autobusë në linjat e transportit publik urban, u propozuan:

- Agim Gashi, LDK,
- Bashkim Beha, PSD,
- Leonora Shabani – Bajraktari, LVV,
- Leutrim Retkoceri, PDK,
- Valbona Ajeti, AAK,
- Vesel Makolli, AKR,
- Kreshnik Smajlaj, nga Grupi i pavarur.

Kryesuesi konstatoi njëzëri se më 25 vota për, u miratua Vendimi për krijimin e Komisionit për caktimin e kritereve për ndarjen e subvencioneve të kompanive private që operojnë me autobusë me linjat e transportit publik urban.

Pika e njëzetë e tetë

Propozimvendimi për shkarkimin e aksionarëve të NPL "Hortikultura".

Lidhur me këtë pikë diskutuan: Leutrim Retkoceri, Egzon Azemi, Muhamet Selmani, Leonora Shabani - Bajraktar, Halimi Halimi dhe Shpend Ahmeti.

Kryesuesi konstatoi se në mungesë të kuorumi, Propozimvendimi për shkarkimin e aksionarëve të NPL "Hortikultura", nuk hyn në procedurë të votimit.

Pika e njëzet e nëntë

Propozimivendimi për ndihmë Komunës së Preshevës, në shumë prej 50.000 euro, me rastin e fatkeqësive natyrore.

Kryesuesi konstatoi se njëzéri, më 30 vota për, u miratua Vendimi për ndihmë Komunës së Preshevës, në shumë prej 50.000 euro, me rastin e fatkeqësive natyrore.

Pika e tridhjetë

Pyetje dhe përgjigje

Halim Halimi, për Shpend Ahmetin, kryetar i Komunës:

- Sipas kërkesës së shërbimit spitalor të Kosovës ose QKUK-së, kërkojnë nga Komuna që t'u ndahet një parcelë diku tek varrezat, për groposjen e placentave, apo si ju thuhet atyre mbetje mortore, ngasjanë mbushur frigoriferët dhe ato duhet të gropohen diku.

Shpend Ahmeti, kryetar, tha se ne nuk kemi nevojë që t'i japim parcelë QKUK-së, por vetëm t'i japim pëlqim që t'i groposin ato mbetje mortore në një vend të caktuar me pëlqim të Komunës, por lë të mbetet pronë e Komunës në shfrytëzim të Komunës.

Berat Lahu, për drejtorin e Drejtorisë së Urbanizmit:

- Kërkoj nga drejtori i kësaj drejtorie që për mbledhjen e radhës të jap sqarime se si ka ardhur puna që të lëshohen kushtet ndërtimore me një parcelë e cila nuk është e tillë, që presupozon se si do ta votonim ne.

- E dyta, ka të bëjë me kërkesën e Ndërmarrjes Publike Banesore lidhur me afatet e shpalljes për shfaqje interesi për ndërtim në zonën më të çmuar të Prishtinës në 100.000 m², të jetë vetëm dy ditë, është absurde kështu. Kisha kërkuar që ndonjëri nga përfaqësuesit e NPB-së, apo kushdo qoftë përfaqësuesi i kryetarit në komision të aksionarëve, ose prej bordit, le të vijnë me sqarime se përsë është kështu, ku janë thirrur, mbi çfarë baze kanë bërë dhe deri ku ka mbërritur ky proces.

Vjollca Rizani, për kryetarin e Komunës:

- Deri ku ka arritur procedura e ndërtimit të atyre katër shkollave që i keni premtuar përmes kredisë së BERZH edhe nëse ka mundësi një përgjigje të ma jepni se a ka qenë në mesin e këtyre katër shkollave, edhe shkolla e lagjes "Qëndresa", sepse me sa e di aty veç ekziston lokacioni.

Lidhur me çështjet e ngritura nga znj. Vjollca Rizani, sqarime shtesë dha Shpend Ahmeti, kryetar.

Kushtrim Sopa, për drejtoren e Drejtorisë së Shërbimeve Publike dhe për drejtorin e Drejtorisë së Investimeve Kapitale dhe Menaxhimit të Kontratave:

- A është ndonjë pengesë apo çfarë është problemi, që ato improvizime që janë bërë në rrëthrrrotullime kanë shkaktuar vetëm kaos, nuk kanë krijuar zgjidhje, si ato te Komuna e re, tek rrathi në Arbëri? Lidhur me këtë çështje kërkoj sqarim.
- Është një kërkesë e qytetarëve të lagjes "Mati" për rrugën "Jakov Xoxa", e cila rrugë është në gjendje të mjerueshme dhe kërkoj të dij arsyen e mos rregullimit të saj, si dhe disa rrugë të cilat lidhen me rrugën "Muharrem Fejza" që janë në gjendje të mjerueshme.
- Po ashtu, është më se i nevojshëm edhe rregullimi i rrugës që e lidh fshatin Shkabaj me atë pjesën tek zjarrfikësit në lagjen "Kodra e Trimave".
- Kërkesë tjetër është që sa më shpejt të përfundojnë punët në hyrje të parkut "Gërmia".
- Gjithashtu, kërkesë tjetër e banorëve është që kanalet të cilat po hapen në rrugë, të mbyllen sa më shpejt, pasi që mos mbyllja e tyre paraqet rrezik në shkaktimin e incidenteve, e në veçanti rrezikohen fëmijët që mund të bien në ato gropat apo kanale.

Egzon Azemi, për kryetarin e Komunës dhe për drejtoren e Drejtorisë së Parqeve:

- Në kuadër të NPB-së është një parcelë jashtëzakonisht e madhe, ku punëtorët e ndërmarrjes janë urdhëruar që t'i lëshojnë lokalet ku kanë qenë deri tash dhe ajo pronë tanë po jepet në koncesion për ndërtim. E kemi parë një dokument të publikuar në faqen e Ndërmarrjes Publike Banesore, ku afati për të konkurruar për bashkëfinancim, pra për t'i ndërtuar ato pallate ka qenë vetëm dy ditë dhe konkursi është hapur të mëkurën dhe është mbyllur të enjten. Për këtë çështje ishte dashur që të kemi më shumë njoħuri si asamblistë, jo të qarkullojnë vetëm me informacione që i marrim prej gazetarëve ose njerëzve të caktuar.
- Është shqetësim i qytetarëve në lidhje me një investim në Parkun e Qytetit, ku ata na kanë dërguar fotografi, janë dy staza të basketit, me nga një kosh shumë afér njëra-tjetrës, dhe aty një shteg është dëmtuar. Janë dëmtuar shumë barishte dhe pjesë të parkut që të bëhet një shteg për këmbësorë, e që këto ndërhyrje banorët po i quajnë të panevojshme, dhe nuk e di a ishte dashur që të kemi diskutime publike ose konsultime me qytetarët para këtyre investimeve.

Lidhur me shqetësimet e ngritura nga z. Egzon Azemi, sqarime të nevojshme dha Shpend Ahmeti, kryetar.

Nazlie Bala tha se një kërkesë e kam adresuar në ujësjellësin rajonal "Prishtina", por asnjëherë nuk kam pasur përgjigje. Të njëjtën kërkesë e kam dërguar edhe te drejtori i Drejtorisë së Inspektoratit, që ka të bëjë me autolarjet dhe kompanitë e taksie. Në ndërtesën ku unë banojë dhe jetojë me qiradhënie, është një kompani auto-taksi, mirëpo autolarjen private që e kanë të tyren nuk besojë që kanë leje për shfrytëzim të ujit. Uji aty shfrytëzohet 24 orë prej autolarjes që është në shërbim të asaj kompanie në rrugën "Bashkim Femi" në lagjen "Arbëria", përballë restorantit "Bell Monde".

Adonis Tahiri, drejtor, tha se pjesa dërmuese e autolarjeve ujin që e shfrytëzojnë nuk e kanë të ujësjellësit, por e kanë të puseve. Bashkë me ekipet e ujësjellësit, shpesh kemi bërë analiza të ujit nëpër autolarje, sidomos në raste të tilla.

Mbledhja përfundoi në orën 15:30.

Procesmbajtësi
Zijadin Gashi

Kryesuesi i Kuvendit

Agim Kuleta



Faqe 15 nga 15